



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Njësia e Prokurimit

Data 24.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Karburanti për vitin 2026”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV 09100000-0 -
Karburante, 09135000-4 - Vajra karburanti**

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,500,000 (Gjashte milion e peseqind mije) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Bashkia HAS ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit

Për çmimin për njësi Grupi i Punës është bazuar në të dhënat e marrë nga bursa “PLATTS” e datës 16 Prill 2026, të botuara në faqen e APP Buletini Nr. 28 datë 20 Prill 2026, duke përlogaritur çmimin me të gjithë elementët fiskal dhe kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date dhe cmimeve të vendosura nga Bordi i transparences.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). **Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime”.**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a. Të plotësoj kriteret e përgjithshme sipas shtojces 8. Objekti i prokurimit të jetë i parashikuar në ekstraktin e operatorit ekonomik. Të paraqitet leja përkatëse për lejimin e tregtimit të karburanteve sipas objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (**Kërkesat për kualifikim**), pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe mbështetur në ligjin Nr. 8450 datë 24/02/1999, “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera”, i ndryshuar. VKM Nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. **Keto kriterë vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar

kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024, 2025 të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, me nenshkrim dhe vule, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar “**Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare**”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme me entin që ka realizuar këtë lloj furnizime shoqëruar me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të

deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara e firmosur dhe vulosur nga palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Të paraqiten raport analizat për mallrat që kerkohen ku të përfshihen të gjithë treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në zbatim të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar nenit 40, pika 6, gërma ”c”(.... *dëshmi për rezultatet e testimave zyrtare...*) e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 22 dhe 23 Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.199 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” i ndryshuar, VKM-së Nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel” pasi Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofruar të përputhen me standartet teknike të kërkuara nga autoriteti Kontraktor. Pra me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë cilësia e mallrave me anë të një raport analize me qëllim për të vërtetuar që karburanti të jet brenda standarteve sipas ligjit për hidrokarburet.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme ose Autorizim për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil), siç përcaktohet në VKM-në me Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 40, pika 5 (***Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon;***, gërma a.) ***licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;***), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe VKM-në me Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet

Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4. Të paraqitet dokumentacion për të vërtetuar që:

Subjekti ofertues duhet të ketë Stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Has, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie). Stacioni i tregtimit me pakicë të karburante detyrimisht duhen të jetë i pajisur me Leje mjedisore te tipit C të lëshuar nga QKL.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM Nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjisllacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin e fundit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 40, pika 5, gërma a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Vërtetim teknik nga ISHTI është vërtetimi që lëshohet për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike) sipas urdhërit Nr. 315 date 24.08.2017 të Ministrit. Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejne aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj.

2.3.6. Formularin e Ofertës i cili duhet të përmbajë vlerën totale të ofertës pa TVSH dhe me TVSH si dhe elementët e përlllogaritjes së saj.

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomiksht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritegt bazuar në:

- a. Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF- Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- b. Elementët fiskal;

c. Normën e fitimit e shprehur në % dhe vlerë absolute(lek), e cila duhet të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Argumentim: Mbështetur në nenin 45 (Kriteret për shpalljen e ofertës fituese), pika 2.1 (Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- Çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF- Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo jave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- Elementët fiskal;
- Normën e fitimit e shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 (një) autobot të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatën matës. Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat (kryesisht kaldaja te shkollave) dhe mjetet e tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor. Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qerave + leje qarkullimi si dhe Çertifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Për arsye të vendodhjes së depozitave (kryesisht kaldaja te shkollave) dhe mjeteve të tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim 1000 (nje mijë)-2000 (dy mije) litra.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 (Kërkesat për kualifikim), të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 (Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave), pika 5/ç (mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.8 Pika e karburantit të jetë e pajisur me autorizim për tregtim karburanti i lëshuar nga njësi vendore ku ushtron aktivitetin.

1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.

2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuara për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor.
3. Subjekti duhet të Deklarojë se e zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.
 - Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme“ Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburantëve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.
 - Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet në mënyrë të pavarur nga vet Autoriteti kontraktor.
 - Faqja e menaxhimit të karburantëve (webpage) duhet të ofrojë informacion dhe raporte të ndryshme të levritimit dhe qarkullimit të karburantit, të jetë e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.
 - Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

2.3.9 **Certifikat ISO: ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe në Kodin e Punës, ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin Nr. 10237 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM Nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM Nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM Nr. 312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të Gazoil 10 ppm ULSD sipas standartit SSH EN 590:2022 ose ekuivalente

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e Testimit
			Min	Max	
1	Numri i Cetanit		51	-	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN 5195 EN 16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	-	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	Kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	-	8	SSH EN ISO 12916
5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	-	10.0	SSH EN ISO 20846 SSH EN ISO 13032 SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e Manganit, nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	-	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55		SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni (ne 10% mbetje destilimi)	% (m/m)	-	0,30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	-	0,01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	-	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	-	24	SSH EN ISO 12662
12	Gryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 ⁰ C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	-	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751
15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë (ësd 1,4) në 60 °C	um(microm)	-	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskozitetit në 40 ⁰ C		2,000	4,500	SSH EN ISO 3104

17	Destilimi % vol e destilati qe vlon deri ne 250°C % vol e destilati qe vlon deri ne 350°C Distilati qe vlon ne 95 % vol.	%(v/v) %(V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924
----	---	------------------------	----	------------	------------------------------------

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: